



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1066
Data e Vendimit: 18.11.2025

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit ekonomik (OE) “N & B” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit “NDERTIMI I KOMPLEKSIT TË BAZENIT OLIMPIK NË LEPOSAVIQ – FAZA 1” me numër të prokurimit 641-25-8093-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KUVENDI KOMUNAL LEPOSAVOQ”, zv. Kryesuesi i Organit Shqyrtues të Prokurimit me datën 18/11/2025, mori këtë:

Vendim

I.Hedhet si jo e plotë ankesa e OE “N & B” SH.P.K me nr. të protokollit 2025/1066, e datës 30/10/2025, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “NDERTIMI I KOMPLEKSIT TË BAZENIT OLIMPIK NË LEPOSAVIQ – FAZA 1”, me numër të prokurimit 641-25-8093-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KUVENDI KOMUNAL LEPOSAVOQ”.

II.I lejohet, autoritetit kontraktues – “KUVENDI KOMUNAL LEPOSAVOQ” që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “NDERTIMI I KOMPLEKSIT TË BAZENIT OLIMPIK NË LEPOSAVIQ – FAZA 1”, me numër të prokurimit 641-25-8093-5-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik e-prokurimi me datë 30/10/2025, tek rubrika e ankesave ka pranuar një ankesë nga OE “N & B” SH.P.K për aktivitetin e prokurimit me “NDERTIMI I KOMPLEKSIT TË BAZENIT OLIMPIK NË LEPOSAVIQ – FAZA 1” me numër të prokurimit 641-25-8093-5-1-1, inicuar nga “KUVENDI KOMUNAL LEPOSAVOQ”

në cilësinë e autoritetit kontraktues.

Zyra e pranimit të ankesave pas pranimit të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka kryer pagesën siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së dhe nenin 69 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Nisur nga fakti se ankuesi ankesën e lartcekur, nuk i ka bashkangjitur konfirmimin e bankës për tarifën, edhe pse zyra për pranimin e ankesave me datën 31/10/2025 përmes email-it e ka njoftuar OE ankues se ankesës se pas ekzaminimit të shkresave që i keni bashkangjitur ne platformë OSHP, ka konstatuar se nuk keni kryer pagesën siç parashihet ne paragrafin 2 te nenit 69 te rregullores 001/2022 te prokurimit publik. citojmë nenin 69.2 “Në përputhje me nenin 118 të LPP-së, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarife të ankesave në OSHP. a. Kurdo që ankesa ndërlihet me vendimin për shpërbllim të një kontrate, shuma e tarifës se ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së parashikuar, por jo më pak se 200 Euro dhe jo më shumë se 10, 000 Euro. Ne rast të aktiviteteve te prokurimit të ndare në LOT (Pjesë), Operatori ekonomik ankues duhet te përcaktohet për cilin LOT (Pjesë) parashtron ankese, Shuma e tarifës se ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së parashikuar për Lot, por jo më pak se 200 Euro dhe jo më shumë se 10, 000 Euro.. andaj luteni që afatin e mbetur te na e përcjellin dëshminë lidhur me pagesën në të kundërtën Ankesa do të refuzohet. Për të cilën OE ankues “N & B” SH.P.K lidhur me e-mailin e dërguar i njëjti nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor.

Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE “N & B” SH.P.K e datës 30/10/2024 (protokoll 2025/1066), për aktivitetin e prokurimit me titull: “NDERTIMI I KOMPLEKSIT TË BAZENIT OLIMPIK NË LEPOSAVIQ – FAZA 1” me numër të prokurimit 641-25-8093-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) “KUVENDI KOMUNAL LEPOSAVOQ”, konsiderohet si e pa kompletuar sepse ankuesi nuk ka deponuar tarifën e sigurimit të ankesës së tij siç kërkohet në piken 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së lidhur me nenin 118 të LPP-së.

Andaj procedura e shqyrtimit të kësaj ankese përfundon në këtë fazë duke e hedhur të njëjtën si palejuar - jo e plotë ngase kjo ankesë nuk plotëson kushtet për tu proceduar më tutje siç kërkohet dispozitat ligjore të lartcekura.

I lejohet, autoritetit kontraktues – “KUVENDI KOMUNAL LEPOSAVOQ” që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “NDERTIMI I KOMPLEKSIT TË BAZENIT OLIMPIK NË LEPOSAVIQ – FAZA 1”, me numër të prokurimit: 641-25-8093-5-1-1, përkritazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit. Megjithatë OSHP i vë në dijeni AK, se në çdo aktivitet duhet të veprojnë konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60 të LPP-së.

Zv. Kryesuesi i OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Agim Sheqiri
U.D. Kryesues i Sekretariatit

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL LEPOSAVOQ**
- **OE - " N & B " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: